



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVETKOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KOMISIONI DISIPLINOR//DISCIPLINSKA KOMISIJA/ THE DISCIPLINARY COMMITTEE

KD.nr.10/2017

KOMISIONI DISIPLINOR, në përbërje nga gjyqtarët: Skender Çoçaj, kryetar, Armend Berisha dhe Gjimeshit Galushi, anëtar të Komisionit, duke e shqyrtuar çështjen e përgjegjësisë disiplinore ndaj Xxxx Xxxxx, gjyqtare në Gjykatën Themelore në Xxxxx, sipas raportit përfundimtar të Zyrës së Prokurorit Disiplinor ZPD-2016-239, i njëjti në procedurë te Komisioni Disiplinor ka marrë numrin KGJK/KD/05/2017, për pretendimin për sjellje të pahijshme të përcaktuar sipas nenit 34 paragrafi 1 pika 1.2, 1.3 dhe 1.4 shkelje e kodit të zbatueshme të etikës sipas Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (Nr.03/L-223), në seancën dëgjimore të mbajtur në prezencën e përfaqësuesit të ZPD-së, z. Kadri Begolli dhe gjyqtarës Xxxx Xxxxx me datë 14.06.2017 merr këtë:

V E N D I M

Xxxx Xxxxx, Gjyqtare në Gjykatën Themelore në Xxxxx, **nuk** është përgjegjëse për sjellje të pahijshme të përcaktuara sipas nenit 34 paragrafi 1 pika 1.2, 1.3 dhe 1.4 shkelje e kodeve të zbatueshëm të etikës të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (Nr.03/L-223), siç është pretenduar në raportin përfundimtar të Zyrës se Prokurorit Disiplinor ZPD-2016-368.

A r s y e t i m

Zyra e Prokurorit Disiplinor i'a ka paraqitur Komisionit Disiplinor të Këshillit Gjyqësor të Kosovës Raportin përfundimtar ZPD-2016-239 se bashku me shkresat e lëndës, më të cilin e ka ngarkuar Xxxx Xxxxx, gjyqtare në Gjykatën Themelore në Xxxxx për sjellje të pahijshme të përcaktuara sipas nenit 34 paragrafi 1 pika 1.2- neglizhencë në kryerjen, dështim për të kryer apo abuzimin e funksioneve gjyqësore, 1.3-të dështuarit të kryerjes së funksioneve gjyqësore në mënyrë të pavarur dhe te paanshme dhe 1.4-shkelje e kodit të zbatueshëm të etikës të përcaktuara sipas Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovë.

Hetimin disiplinore ZPD e kishte filluar në bazë të informatës së pranuar nga Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese (BIRN) e cila ka pretendon në neglizhencë në kryerjen e funksioneve gjyqësore të Xxxx Xxxxx, Gjyqtare në Gjykatën Themelore në Xxxxx, për shkak të vonesës në vendosje, duke rezultuar në parashkrimin absolut të ndjekjes veprës penale në lëndën PKR.nr.705/2013.ZPD e ngarkon gjyqtare Xxxxxx për neglizhencën qe ka treguar gjatë procedimit të rastit penal, që për afërsisht 2 vite nuk ka ndërmarr veprime procedurale ose veprimet e

ndërmarrë kanë qenë të pa mjaftueshme dhe si rezultat i të cilave ka ardhur deri të parashkrimi absolut i lëndës penale me të cilën ka qenë i ngarkuar i akuzuari Xxxxx Xxxxx. I propozoj Komisionit të marrë parasysh provat materiale, deklaratën e gjyqtarës dhe te procedoj me tutje me këtë rast.

Në seancën dëgjimore të komisionit të mbajtur me datë 14.06.2017, gjyqtarja Xxxx Xxxxx deklaroj se qëndron pran deklaratës që e ka dhënë për ZPD-ën me datë 5 nëntor 2016. Neni 90 i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës-së, kur është fjala për parashkrimin e ndjekjes penale fillimisht për veprën për të cilën unë tash jam para juve Komision i nderuar, neni 339 paragrafi 2 dënimi parashihet deri në tri vite burgim. Vepra penale për të cilën është dyshuar që është kryer në vitin 26.01.2009, aktakuza është ngritur me datë 30.12.2013, që do të thotë që aktakuza është ngritur pas 4 vite e 11 muaj, çka do të thotë se prokurori nuk ka pasur fare të drejt ta ngrisë aktakuzën. Është dashur që ti pushoj hetimet për shkak të parashkrimit relativ të ndjekjes penale, meqë kishin kaluar me shumë se tri vite nga dyshimi i kryerjes së veprës penale. Organi i akuzës nuk është dashur që ta ri kualifikoj veprën penale me Kodin Penal të Republikës së Kosovës me neni 422 paragrafi 1 të këtij Kodi, por me kodin e vjetër, d.m.th. vepra penale është dyshuar që është kryer me kodin e vjetër ndërsa prokurori e ka bërë rikualifikimin e kësaj vepre me kodin e ri, Kodin Penal të republikës së Kosovës. Në shkresa të lëndës e keni edhe aktgjykimin të cilin gjyqtarja e kishte marrë më propozim të prokurorit, i cili kishte hequr dorë nga ndjekja penale për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale. Theksoj se ajo asnjëherë nuk i shikon emrat e të akuzuarve, kanë qenë shumë të ngarkuar me lëndë dhe se në këtë kohë ka qenë edhe greva e gjyqtarëve.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i ZPD-së deklaroj se nisur nga korniza ligjore ekzistuese e ligjit për KGJK-ën e që i referohen procedurave disiplinore dhe punës në ZPD, është e tillë që nuk e lejon që në këtë fazë të procedurës me e ndër marr ndonjë veprim tjetër për veç asaj që raporti të mbështetet.

Gjyqtarja Xxxxxx në fjalën përfundimtare kërkoj nga Komisioni që të pushohet procedura disiplinor.

Komisioni Disiplinor i administroj të gjitha provave në shkresat e lëndës: shkresën e dërguar nga BIRN e datës 19 maj 2016 shkresë kjo e dorëzuar në Zyrën e Prokurorit Disiplinor, deklaratën e gjyqtarës Xxxx Xxxxx dërguar ZPD-së në Prishtinë e datës 20.10.2016, aktvendimi për fillimin e hetimeve i Prokurorisë së Qarkut në Xxxxx, PPH.nr.156/2012 date 23 10.2012, aktvendimi për pushimin e hetimeve gjithashtu i Prokurorisë Themelore në Xxxxx, Departamenti i Krimeve të Rënda, numër PP.nr.156/2013, aktakuzën e ngritur nga Prokuroria në Xxxxx-Departamenti për Krime të Rënda me numër PP.nr.156/2012 datë 13.12.2013, procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor PKR/705/2013, i përpiluar me datë 18 mars 2015, procesverbalin e shqyrtimit fillestar, me numër PK.nr.705/13, i përpiluar me datë 27.10.2015, procesverbalin e shqyrtimit të dytë, PKR.nr.705/13 përpiluar me 1.12.2015, bëhet leximi i aktgjykimin të Gjykatës Themelore në Xxxxx Departamenti i

Krimeve të Rënda, PKR.nr.705/13, i datës 1.12.2015, dhe bëhet shikimi i regjistrit të Gjykatës Themelore në Xxxxx për pranimin dorëzimin e lëndëve të pranuar nga gjyqtarja Xxxxxx.

Në bazë të provave të analizuara me kujdes, Komisioni konstaton se gjyqtarja Xxxxxx nuk ka bërë sjellje të pahijshme, nuk ka neglizhencë në kryerjen, dështim për të kryer apo abuzim të funksioneve gjyqësore, nuk ka dështuar të kryej funksionet gjyqësore në mënyrë të pavarur dhe të paanshme dhe nuk ka shkelur kodin relevant të etikës për gjyqtar, me rastin e parashkrimit absolut të ndjekjes penale në lëndën PKR.nr.705/2013. Aktakuza për këtë veprë penale në Gjykatë ishte pranuar me datë 31 dhjetor 2013, lënda ishte regjistruar me numër PKR.nr.701/2013 dhe i ishte ndarë në pune gjyqtares Xxxxxx me datë 03 janar 2014. Shqyrtimin fillestar gjyqtarja e kishte caktuar me datë 18.03.2015, e cila nuk ishte mbajtur për arsye të mungesës së të autorizuarit Avdullah Emmini dhe mbajtjes së grevës në tërë gjyqësor. I njëjti ishte mbajtur me datë 27.10.2015, ndërkaq shqyrtimi i dytë është mbajtur me datë 01.12.2015, brenda afatit të paraparë ligjor. Në këtë seancë të shqyrtimi të dytë prokurori i çështjes ka bërë rikualifikimin e veprës penal duke bërë ndryshimin e dispozitivit të aktakuzës përkitazi me cilësimin juridike veprës penale duke hequr cilësimin ekzistues të veprës penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me neni 31 të KPRK-së dhe në vend të këtij cilësimi ka vendosur veprën penale shpërdorimi i pozitës zyrtare apo autorizimit nga neni 339 par.2 të KPK-së, ri cilësim të cilin e ka bërë sipas prokurorit me që dispozita e vjetër është më e favorshme për të akuzuarit e që parash dënimin me burgim deri me 3 vjet.

Në vazhdim prokurori gjatë seancës së shqyrtimi të dytë është deklaruar se meqenëse nga koha e kryerjes së veprës penale përkatësisht nga data 26 janar 2009 e gjer me tani kanë kaluar me shume se 6 vite behët fjalë për vjetërsim absolut të veprës penale në kuptim të nenit 107 par.8 të KPRK-së, andaj për shkak të parashkrimit absolut të veprës penale ka hekur dorë nga ndjekja penale.

Në rrethana të lartpërmendura, Komisioni konstaton se gjyqtarja Xxxxxx nuk ka kurrfarë përgjegjësie disiplinore sa i përket kësaj çështje penale, për shkak se është vetë prokurori i cili ka bërë ri cilësimin e veprës penale e si rezultat i këtij ri cilësimi edhe ka hekur nga ndjekja penale për çka edhe gjyqtarja ka marrë aktgjykim refuzues në rastin konkret.

Duke patuar parasysh të gjitha këto, Komisioni vlerëson se në këtë rast gjyqtarja Xxxx Xxxxxx nuk ka kryer sjellje të pahijshme siç pretendon ZPD dhe nuk është involvuar me ndonjë veprim konkret që do të rezultonte me shkelje të standardeve të sjelljeve profesionale për gjyqtarë.

Prandaj, nga këtu dhe nga arsyet e sipër theksuara, Komisioni ka konstatuar se gjyqtarja Xxxxxx **nuk** është përgjegjëse për sjellje të pahijshme të parapara me dispozitat e nenit 34 paragrafi 1, pika 1.2, 1.3 dhe 1.4 të ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, si dhe nuk ka shkelur standardet e Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Gjyqtar. Në seancën për këshillim dhe votim, njëzëri

vendosi qe Xxxx Xxxxx, gjyqtare në Gjykatën Themelore në Xxxxx të lirohet nga përgjegjësia disiplinore, prandaj vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR
KD.nr.10/2017, datë 14.06.2017

Kryetar i Komisionit Disiplinor
Gjyqtari, Skender Çoçaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese pranë Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në Prishtinë, brenda 15- ditësh nga dita e pranimt të Vendimit.

Vendimi t'u dërgohet:

- Nehat Idrizi, kryesues i KGJK-ës;
- Zef Prendrecaj, drejtor, Zyra e Prokurorit Disiplinor;
- Xxxx Xxxxx, u.d i kryetar i Gjykatës Themelore në Xxxx;
- Xxxx Xxxxx, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Xxxxx;
- Departamentit të Administratës dhe Personelit në SKGJK;

